



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 224, Datë 10.08.2026

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-S LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GERTI” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/15 prot., datë 07.08.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “GERTI” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 02.07.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të këtij aplikimi, bordi i ERE-s me vendimin nr. 194, datë 13.07.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.07.2026 dhe 16.07.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 27.07.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- Me shkresën nr. 2015/9 prot., datë 20.07.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit/informacionit të munguar të aplikimit. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015/10 prot., datë 22.07.2026, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit, ndaj me e-mailin e datës 06.08.2026, ERE i ka kujtuar shoqërisë të depozitojë planin e biznesit dhe dokumentacionin mbështetës financiar për ushtrimin e veprimtarisë.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015/14 prot., datë 07.08.2026, shoqëria ka depozituar sërish planin e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, veprimtari për të cilën ka aplikuar paralelisht në ERE. Ky dokument nuk plotëson kërkesat për planin e biznesit për veprimtarinë për të cilën kërkohet licencimi, ndaj shoqëria duhet të depozitojë planin e dedikuar të biznesit për tregtimin, si dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare.
- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,

*transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, parashikohet: “Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.”.*

- Për sa më sipër dhe me qëllim për të zhvilluar korrespondencën dhe sqarimet përkatëse me shoqërinë dhe për t'i dhënë kohë asaj për të plotësuar dokumentacionin e munguar, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GERTI” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Shoqëria “GERTI” sh.p.k. të depozitojë në ERE, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, planin e biznesit të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe dokumentacionin mbështetës financiar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “GERTI” sh.p.k., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**